

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**PUNIME DHE RIPARIM RRUGËSH**

**Niveli III i KSHK**  
**(1 vjeçar)**

**(Në drejtimin mësimor “Ndërtim”)**

**Kodi: B4-III-23**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2023**

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Ndërtim”**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**
  1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK
  3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK
- III. Plani mësimor për profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh” 1 vjeçar, niveli III i KSHK, të drejtimit “Ndërtim”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Ndërtim”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet e rrugëve dhe riparimin e tyre. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit të formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III I KSHK**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efëçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II i KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të analizojë, planifikojë dhe kryejë organizimin e vogël të punës në punimet e shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të kryejë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të planifikojë nevojën e burimeve njerëzore.
- Të ndajë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik në punimet e shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të kryejë procese parapërgatitore për punime e shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të kryejë matje dhe shënime të sakta sipas fletës së projektit.
- Të kryejë punime piketimi e modinimi të aksit të trasesë së rrugës.
- Të kryejë punime gërmimi dhe mbushje në rrugë.
- Të kryejë punime të shtresave në trupin e rrugës.
- Të kryejë punime të veprave të artit në rrugë.
- Të kryejë punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
- Të kryejë punime ndërtimi trotuari.
- Të kryejë punime të rrjetit inxhinierik në rrugë.
- Të kryejë punime të gjelbërimit e sinjalistikës rrugore.
- Të konstatojë parregullsitë gjatë punimeve të shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe të MKZ.
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve mbas kryerjes së punimeve sipas standartit të ndërtimit.
- Të kryejë detyra administrative e tregtare për punimet e shtrimit dhe riparimit të rrugëve.
- Të ngrejë nivelin profesional për punime të shtrimit dhe riparimit të rrugëve.

- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të përdorë mjete digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

### 3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me Certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në kompani ndërtimi në punime të rrugëve dhe riparimit të tyre, për t’u vetëpunësuar si individ i lirë ose mbas një përvoje pune të angazhohet si sipërmarrës duke punësuar individë të tjerë në veprimtari të punimeve të rrugëve dhe riparimit të tyre.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Ndërtim”, për të fituar diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK

<b>Plani mësimor për profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)</b>			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ Vjetore
			Klasa 12
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>8/9</b> (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>7 (238)</b>
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-01-610-23	Vizatimet e ndërtimit për rrugë dhe vepra arti	1
3	L-02-611-23	Teknologjia e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve	3
4	L-02-612-23	Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>12</b> (408)
1	M-02-1914-23	Punime piketimi dhe modinimi të rrugëve	66
2	M-02-1915-23	Punime gjurmimi dhe mbushje në rrugë	69
3	M-02-1916-23	Punime të shtresave në trupin e rrugës	120

4	M-02-1917-23	Punime ndërtimi të veprave të artit në rrugë	69
5	M-02-886-23	Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve	84
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar</b> (Gjithsej)	<b>3</b> (102)
1	M-02-1918-23	Punime ndërtimi trotuari	51
2	M-02-1919-23	Punime të rjetit inxhinierik në rrugë	51
3	M-02-1536-23	Punime të sinjalistikës rrugore	51
4	M-02-1537-23	Punime gjelbërimi në rrugë	51
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1020/ 1054)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3-orëshe ose 6-orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integriteti i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Punime dhe riparim rrugësh”.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e punimeve dhe riparimit të rrugëve.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës për këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë

<b>Tema 1</b>	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
<b>Tema 2</b>	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
<b>Tema 3</b>	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
<b>Tema 4</b>	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
<b>Tema 5</b>	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
<b>Tema 6</b>	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe	3 orë



	dështimeve	
<b>Tema 7</b>	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
<b>Tema 8</b>	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
<b>Tema 9</b>	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
<b>Tema 10</b>	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
<b>Tema 11</b>	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
<b>Tema 12</b>	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
<b>Tema 13</b>	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
<b>Tema 14</b>	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
<b>Tema 15</b>	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
<b>Tema 16</b>	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
<b>Tema 17</b>	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
<b>Tema 18</b>	Marrëdhëniet e punës	4 orë
<b>Tema 19</b>	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

## 2. Lënda “Vizatimet e ndërtimit për rrugë dhe vepra arti” (L-01-610-23) Kl. 12 - 34 orë

### • Synimet e lëndës “Vizatimet e ndërtimit për rrugë dhe vepra arti”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatimet e ndërtimit për rrugë dhe vepra arti”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë plane rievimi për terrene të ndryshme.
- Të vizatojnë shkallët grafike gjatësore dhe tërthore;
- Të lexojnë planimetrinë aksiale, në planin me izoipse;
- Të lexojnë profilin gjatësor dhe profilet tërthore të trasesë së rrugës;
- Të lexojnë shkallën e pjerrësisë së trasesë nga piketa në piketë;
- Të vizatojnë planimetrinë aksiale, në planin me izoipse;
- Të vizatojnë profil gjatësor dhe profilet tërthore të trasesë së rrugës
- Të lexojnë vizatimet e fletëve të projekt-zbatimit të rrugës;
- Të vizatojnë detaje sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje në rrugë e vepra arti;
- Të interpretojnë vizatimet e fletëve konstruktive të projekt-zbatimit të rrjetit inxhinierik të rrugëve dhe veprave të artit.
- Të vizatojnë në plan e prerje vepra arti (urë, tombino, tunel etj.) si dhe detaje sipas përmasave të dhëna në projekt-zbatim;
- Të lexojnë skicat e rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti, si dhe shenjat dalluese të përdorura.
- Të vizatojnë detajet e rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti, si dhe shenjat dalluese të përdorura.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatimet e ndërtimit për rrugë dhe vepra arti”, kl. 12 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Vizatimi i shkallës grafike gjatësore dhe tërthore	6 orë
<b>Tema 2</b>	Vizatimi i planimetrisë aksiale, në planin me izoipse	4 orë
<b>Tema 3</b>	Vizatimi i profilit gjatësor të trasesë së rrugës	6 orë
<b>Tema 4</b>	Vizatimi i profileve tërthore të trasesë së rrugës	6 orë
<b>Tema 5</b>	Vizatimi i elementeve të veprave të artit në plan e prerje	5 orë
<b>Tema 6</b>	Vizatimi i elementeve të rrjetit inxhinierik në plan e prerje	5 orë

### **3. Lënda “Teknologjia e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve” (L-02-611-23). Kl. 12 - 102 orë**

- **Synimet e lëndës “Teknologji e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve”, kl.12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rrugët, tipat, llojet, elementet përbërëse të tyre (traseja, nënshtresat, mbishtresat, karexhatat, sinjalistika horizontale e vertikale, gjelbërimi dhe ndriçimi).
- Të klasifikojnë rrugët sipas kategorive.
- Të përshkruajnë fazat e studimit të rrugës.
- Të përshkruajnë hapat për piketimin e rrugëve të kategorive të ndryshme në terren;
- Të përshkruajnë hapat e punimeve të modinimit të trasesë së rrugëve për gjermim dhe mbushje të saj sipas kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë elementet kryesore të kthesës, zgjerimin dhe pamjen e lirë të saj.
- Të përshkruajnë hapat e punimeve të gjermimit dhe mbushjes së trasesë së rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të interpretojnë ndërtimin e gjurmës së rrugës në plan së bashku me profilin gjatësor e profilet tërthore dhe tabelën e vëllimeve të dherave.
- Të lexojnë skicat dhe specifikimet për çdo punim të elementeve të trupit të rrugës (trasesë, nënshtresave, mbishtresave, karexhatave, parapeteve, sinjalistikës horizontale e vertikale, gjelbërimit dhe ndriçimit).
- Të lexojnë ndërtimin e gjurmës së rrugës në plan së bashku me profilin gjatësor e profilet tërthore dhe tabelën e vëllimeve të gjermimit e mbushjes.
- Të përshkruajnë mënyrën e bashkëpunimit me topografin për piketimet;
- Të përshkruajnë përbërjen e grupit të trasimit e piketimit, të rrugës në terren;
- Të përshkruajnë mënyrën e bashkëpunimit me manovratorët e makinerive për punimet e gjermimit të trasesë së rrugës;
- Të përshkruajnë mënyrën e heqjes së dherave dhe materialeve të panevojshme;
- Të përshkruajnë metodat e gjermimit për kasonetën e rrugë, skarpatet, pusetat, kunetat, themelet e muret pritëse/mbajtëse dhe në pjesët e deformatuara të rrugës, në funksion të terrenit, klimës dhe formacioneve të tokës në zonën ku ndërtohet rruga.
- Të përshkruajnë hapat për nivelimin dhe ngjeshjen pas gjermimit;
- Të përshkruajnë mënyrën e bashkëpunimit me manovratorin për realizimin e shtresave;
- Të përshkruajnë teknikën e kontrollit të kuotave të shtresave;
- Të përshkruajnë hapat për punimet e ndërtimit shtresave të rrugës të rrugëve të kategorive të ndryshme;

- Të përshkruajnë hapat për ndërtimin e kasonetës, nënshtresës, themeleve dhe shtresave të rrugës, sipas kategorive të saj.
- Të përshkruajnë llojet e punimeve dhe hapat për zgjerimin e rrugëve sipas kategorive.
- Të përshkruajnë teknikën e lagjes me ujë të shtresave të stabilizantit, të ngjeshjes së çdo shtrese sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Të përshkruajnë metodën e vendosjes së piketave në sipërfaqen që do asfaltohet;
- Të përshkruajnë teknikën e spërkatjes me prajmer para asfaltimit;
- Të përshkruajnë hapat për punimet e shtrimit dhe ngjeshjes me asfalto-beton të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë mënyrat e lidhjes së rrugëve me kategori të njëjtë dhe të ndryshme.
- Të përshkruajnë teknikën e ndërtimit të kunetave të shiut në rrugë;
- Të përshkruajnë punime në veprat e artit si urat, tunelet, kryqëzimet, mbikalimet, nënkalimet, tombinot, pusetat, kanalet muret pritëse/mbajtëse, në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë llojet dhe karakteristikat e veprave të artit, elementet përbërëse si urat, tunelet, kryqëzimet, mbikalimet, nënkalimet, tombinot, pusetat, kanalet, muret pritëse/mbajtëse në rrugë dhe funksionin e secilit element;
- Të interpretojnë skicat dhe specifikimet për veprat e artit si ura, tombino, puseta, kanale, tunelet, kryqëzimet, mbikalime, nënkalimet muret pritëse/mbajtëse etj;
- Të përshkruajnë punime për rrjetit inxhinierik në rrugë të kategorive të ndryshme.
- Të përshkruajnë llojet dhe karakteristikat për rrjetit inxhinierik në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të interpretojnë skicat dhe specifikimet për rrjetit inxhinierik në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë elementet mbrojtëse në rrugë, funksionin, mënyrat e vendosjes dhe rëndësinë e tyre për funksionimin normal të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë sinjalistikën në rrugë tipet, llojet, elementet përbërëse të tyre, funksionin e secilit element;
- Të përshkruajnë teknikat dhe hapat për punimet e elementeve mbrojtëse, sinjalistikës në rrugë të kategorive të ndryshme, sipas projektit;
- Të lexojnë skicat dhe specifikimet për elementet mbrojtëse, sinjalistikën rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë teknikat e vijëzimit të sinjalistikës rrugore me makineri apo me dorë dhe mënyrën e instalimit të elementeve mbrojtëse në rrugë;
- Të përshkruajnë llojet e gjelbërimit dhe mënyrën e vendosjes së gjelbërimit në rrugë;
- Të përshkruajnë trotuaret, tipet, llojet, elementet përbërëse të tyre;
- Të përshkruajnë teknikën e kontrollit të kuotave dhe e nivelimit të shtresave të trotuareve;
- Të përshkruajnë teknikën e shtrimit dhe nivelimit të shtresës së betonit poshtë bordurave të trotuareve dhe vendosjes së bordurave b/a të trotuareve;
- Të përshkruajnë teknikën e punimit të trotuareve me materiale të ndryshme;
- Të përshkruajnë mënyrat, teknikat dhe hapat e mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve dhe elementeve mbrojtëse të kategorive të ndryshme sipas kushteve teknike të shfrytëzimit të tyre;
- Të përshkruajnë rëndësinë e identifikimit të rrjeteve inxhinierike nëntokësore për të shmangur dëmtimet e tyre gjatë punimeve të riparimeve në rrugë;
- Të lexojnë skicat dhe specifikimet për punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve të kategorive të ndryshme, përfshirë dhe elementet mbrojtëse, sinjalistikën e gjelbërimit;
- Të përshkruajnë hapat për punimet e riparimit në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajnë teknikat e prerjes, gërmimit, mbushjes me çakëll ose stabilizant të sipërfaqes së dëmtuar të rrugës dhe trotuareve;

- Të përshkruajnë teknikat e riparimit të asfaltimit në sipërfaqet e dëmtuara;
- Të përshkruajnë teknikat e riparimit të veprave të artit në rrugë;
- Të përshkruajnë teknikat për riparimin e sinjalistikës rrugore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve”, kl. 12- 102 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për rrugët	6 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për fazat e studimit të rrugës	8 orë
<b>Tema 3</b>	Paraqitja e rrugëve në plan dhe trasimit të saj	8 orë
<b>Tema 4</b>	Teknologjia e punimeve për ndërtimin e rrugës	10 orë
<b>Tema 5</b>	Teknologjia e punimeve të gërmimit në rrugë	8 orë
<b>Tema 6</b>	Teknologjia e punimeve në veprat e artit, tombinot, pusetat dhe kanalet	10 orë
<b>Tema 7</b>	Teknologjia e punimeve në veprat e artit të mureve pritëse/mbajtëse dhe skarpatave	8 orë
<b>Tema 8</b>	Teknologjia e punimeve të shtresave në trupin e rrugës	12 orë
<b>Tema 9</b>	Teknologjia e punimeve të trotuareve në rrugë	8 orë
<b>Tema 10</b>	Teknologjia e punimeve në mirëmbajtje dhe riparime rrugësh	8 orë
<b>Tema 11</b>	Teknologjia e punimeve në sinjalistikën rrugore dhe gjelbërimin	8 orë
<b>Tema 12</b>	Teknologjia e punimeve në rrjetin inxhinierik në rrugë	8 orë

**4. Lënda “Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti” (L-02-612-23). Kl. 12 - 34 orë**

• **Synimet e lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti” kl.12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të listojnë llojet e konstruksioneve mbajtëse në rrugë dhe vepra arti;
- Të përshkruajnë elementet konstruktive mbajtëse prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura në rrugë dhe vepra e artit;
- Të interpretojnë skica konstruktimi të elementeve të ndryshme konstruktive mbajtëse prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura në rrugë dhe vepra e artit;
- Të interpretojnë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit (Fa) për elemente konstruktive prej betoni të armuar në rrugë e vepra arti;
- Të përcaktojnë numrin dhe diametrin (n dhe Ø) të shufrave për Fa të dhënë për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar me përmasa të dhëna.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për strukturat prej betoni të armuar në rrugë e vepra arti;
- Të hartojnë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit për elementet e mësipërme prej betoni të armuar;
- Të përshkruajnë llojet konstruksionesh mbajtëse me druri dhe metali në vepra arti;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti”, kl.12- 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive mbajtëse prej betoni të armuar në rrugë dhe vepra arti	8 orë
<b>Tema 2</b>	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve mbajtëse prej betoni të armuar në rrugë dhe vepra arti	10 orë
<b>Tema 3</b>	Skicimi i armaturës së hekurit në konstruktimin e elementeve mbajtëse prej betoni të armuar në rrugë dhe vepra arti	8 orë
<b>Tema 4</b>	Konstruksionet mbajtëse prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura në rrugë dhe vepra e arti	4 orë
<b>Tema 5</b>	Konstruksionet mbajtëse prej druri dhe metali në vepra arti	4 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Punime piketimi dhe modinimi të rrugëve”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>PUNIME PIKETIMI DHE MODINIMI TË RRUGËVE</b>	<b>M-02-1914-23</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet e piketimit dhe dhe modinimit të rrugës	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	66 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxëniet (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RN 1</b> <b>Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet në punimet e gërmimeve e mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të llogaritin vëllimet e gërmimit dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës sipas projektit;</li><li>- të hartojnë tabelën e dherave për kompesimin gjatësor të punimeve të dherave sipas llogaritjeve për vëllimet e gërmimit dhe mbushjes sipas projektit;</li><li>- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punimet e gërmimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>- të përcaktojnë radhën e kryerjes së gërmimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>- të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e gërmimeve e mbushjes në aksin e</li></ul>	

---

trasesë së rrugës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës;
- të vendosin sinjalistikën provizore rrugore;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e gërmimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të realizojnë njohjen me terrenin ku do të kryhet gërmimi dhe mbushja në aksin e trasesë së rrugës;
- të pastrojnë paraprakisht sipërfaqen që do punohet nga barishtet e këqija dhe mbetjet e rrezikshme;
- të interpretojnë dhënien e pikës së fillimit dhe të mbarimit të rrugës në bashkëpunim me topografin sipas projektit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë piketimin dhe modinimin e rrugës**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të theksojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për piketime dhe modinimi në rrugë;
- në bashkëpunim me topografin të hedhin në terren pikat kryesore dhe ndërmjetëse të aksit të rrugës;
- të hedhin në terren vertekset me metoda gjeodezike (koordinatat ortogonale dhe objektet ekzistuese);
- në bashkëpunim me topografin të hedhin në terren elementet e kthesës dhe të bëjnë piketimin e detajuar të kthesës nëpërmjet pikave kryesore të kthesës T.S.B. dhe pikave ndërmjetëse të saj;
- të kryejnë piketimin e aksit të rrugës nëpërmjet hedhjes në terren të pikave të rrugës sipas llojit;
- të kryejnë modinimin e rrugës në sipërfaqe të pjerrët, në mbushje të lartë, me dhe pa bankinë sipas llojeve të rrugëve;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;

- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas piktimit dhe modinimit në rrugë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore si dhe piktimit dhe modinimit të rrugës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe piktimin e modinimit të rrugës.
- Nxënësit duhet të përdorin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet e piktimit dhe modinimit të rrugës.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore dhe piktimit dhe modinimit të rrugës, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për punime piktimi dhe modinimi të rrugës.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e piktimit dhe modinimit të rrugës,
  - Instrumentet gjeodezike dhe mjetet ndihmëse.
  - gozhda,përforcues,modina,shënues,çekiç
  - Pajisje kancelarie,makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës dhe tabela e dherave.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-



## 2. Moduli “Punime gjermimi dhe mbushje në rrugë”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME GËRMIMI DHE MBUSHJE NË RRUGË</b>	<b>M-02-1915-23</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet gjermimit dhe mbushjes në rrugë.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxënësve (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet në punimet e gjermimeve e mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të llogaritën vëllimet e gjermimit dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës sipas projektit;</li><li>- të hartojnë tabelën e dherave për kompesimin gjatësor të punimeve të dherave sipas llogaritjeve për vëllimet e gjermimit dhe mbushjes sipas projektit;</li><li>- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punimet e gjermimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe pajisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>- të përcaktojnë radhën e kryerjes së gjermimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;</li><li>- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>- të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera të punës;</li><li>- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e gjermimeve e mbushjes në trasesë së rrugës.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	

---

## **RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës;
- të vendosin sinjalistikën provizore rrugore;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e gjurmimeve dhe mbushjes në aksin e trasesë së rrugës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të realizojnë njohjen me terrenin ku do të kryhet gjurmimi dhe mbushja në aksin e trasesë së rrugës;
- të pastrojnë paraprakisht sipërfaqen që do punohet nga barishtet e këqija dhe mbetjet e rrezikshme;
- të kontrollojnë elementet e trasesë së rrugës sipas modinimit të bërë;
- të kontrollojnë kuotat e shtresave të rrugës para punimeve;
- të heqin materialet e panevojshme;
- të kryenë zbankimin e dherave vegjetale me krahë dhe makineri sipas kushteve teknike;
- të kryejnë punimet e shpyllëzimit sipas modinimit të bërë duke zbatuar kushtet teknike.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RN 3 Nxënësit kryejnë punimet e gjurmimit dhe mbushjes në trupin e rrugës.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të theksojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjurmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës;
- të kryejnë punimet e dheut në gjurmim me krahë sipas modinimit të bërë;
- të kryejnë punimet e dheut ndihmëse sipas modinimit të bërë pas gjurmimit me makineri;
- të kryejnë punimet e dheut në gjurmim në sipërfaqe të rrafshët sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike;
- të kryejnë punimet e dheut në gjurmim në shpat mali për muret mbrojtëse, sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike;
- të kryejnë punimet e dheut me shtresa homogjene sipas modinimit të bërë dhe projektit të rrugës;
- të kryejnë punimet e dheut me shtresa të ndryshme të veçanta (jo homogjene) sipas modinimit të bërë dhe

- projektit të rrugës;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas kryerjes së gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe kryerjen e gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe kryerjes së gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet e gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceseve parapërgatitore dhe kryerjes së gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për kryerjen e gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së gërmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës.
  - Instrumentet gjeodezike dhe mjetet ndihmëse.
  - Makineri gërmimi,transportues dherash, lopata, kazma, bel,
-

- 
- shat, karroca, çekiç, spango etj.
- Pajisje kancelarie, makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

### 3. Moduli “Punime të shtresave në trupin e rrugës”

Drejtimi: Ndërtim  
Profili: Punime dhe riparim rrugësh  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË SHITESAVE NË TRUPIN E RRUGËS	M-02-1916-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet e shtresave në trupi e rrugës.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet në punimet e trupit të rrugës;</li><li>- të llogaritin vëllimet e materialet për punimet e shtresave në trupit e rrugës sipas projektit;</li><li>- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punimet e trupit të rrugës;</li><li>- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>- të përcaktojnë radhën e punës për kryerjen e punimeve në trupit e rrugës;</li><li>- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>- të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve në trupit e rrugës.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshin uniformën e punës;</li></ul>	

- të vendosin tabelat sinjalizuese për punime në rrugë;
- të kontrollojnë kuotat e shënuara përkatëse për shtresat në punimet e trupit të rrugës;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës para përdorimit;
- të sigurojnë furnizimin me ujë dhe energji elektrike;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë punime për nënshtresat në trupin e rrugës.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në trupit të rrugës;
- të kryejnë ngjeshjen e sipërfaqes së rrugës mbas gërmimeve të bëra;
- të hedhin shtresën e parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike;
- të ndjekin lagjen me ujë të shtresave inerte me makineri;
- të kryejnë në bashkëpunim me manovratorin cilindrimin e shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike me makineri;
- të hedhin shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr të imët / çakëll sipas kushteve teknike.
- të kryejnë cilindrimin e shtresës së dytë në bashkëpunim me manovratorin (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike me makineri;
- të largojnë materialet e tepërta dhe të panevojshme që dalin gjatë punës;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të nënshtresave në trupin e rrugës;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve të nënshtresave në trupin e rrugës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësit kryejnë punime për një shtresë të rrugës me çakëll të tipit makadam.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punimet e një shtrese të rrugës me çakëll
- në bashkëpunim, të shpërndajnë dhe profilojnë çakëllin në

- rrugë sipas kushteve teknike;
- të ngjeshin shtresën e çakëllit me mekanizëm ngjeshës sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- në bashkëpunim, të ngjeshin shtresën e çakëllit të spërkatur me ujë me mekanizëm ngjeshës sipas kushteve teknike;
- të shpërndajnë granilin dhe pluhurin e gurit në rrugë dhe t'i spërkatin ato me ujë sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- të kryejnë cilindrimin përfundimtar të shtresës me makinë cilindruese sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë shtrimit të shtresës së rrugës me çakëll të tipit makadam;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas shtrimit të shtresës së rrugës me çakëll të tipit makadam.

***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësit kryejnë punime për themelet e rrugës me dhera të përpunuara**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punimet e themeleve të rrugës me dhera të përpunuara;
- të përgatitin materialin bazë (dherat), sipas kushteve teknike;
- të shpërndajnë materialin lidhës (gëlqere, çimento, bitum) mbi materialin bazë sipas kushteve teknike;
- të përziejnë materialin bazë me atë lidhës sipas kushteve teknike;
- të shpërndajnë përzierjen e materialeve në rrugë mbi shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr/çakëll të cilindruar sipas kushteve teknike;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve të themeleve të rrugës me dhera të përpunuara.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RN 6 Nxënësit kryejnë punime asfaltimi me spërkatje.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punimet e asfaltimit me spërkatje

#### ***a ) për asfaltim me penetrim të thellë:***

- të shpërndajnë çakëllin 50-25 mm, ta cilindrojnë atë dhe të bëjnë spërkatjen e parë me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike;
- të shpërndajnë granilin e trashë 25-15 mm, ta cilindrojnë atë dhe të bëjnë spërkatjen e dytë me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike;
- të shpërndajnë granilin 15-5 mm dhe bëjnë ngjeshjen përfundimtare me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike;

#### ***b) për asfaltim me penetrim të lehtë:***

- të pastrojnë sipërfaqen dhe ta spërkatën atë me bitum të lëngshëm me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- të shpërndajnë çakëllin e imët 35-25 mm, ta cilindrojnë atë dhe ta spërkatën me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- të shpërndajnë granilin e trashë 25-15 mm dhe atë të imët 15-5 mm dhe ta cilindrojnë shtresën me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin;
- të shtrojnë shtresën e binderit me mekanizëm sipas kushteve teknike;
- të kryejnë cilindrimin e shtresës së binderit me mjetin ngjeshës (cilindruës) sipas kushteve teknike;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve të asfaltimi me spërkatje.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe punimet në trupin e rrugës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe punimet në trupin e rrugës.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe



---

mjetet në punimet e trupit të rrugës.

- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe punimet në trupin e rrugës, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makineritë dhe materialet e mëposhtme:

- Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit
  - Pankarta me skica, detaje për kryerjen e punimeve në trupin e rrugës
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese, instrumentet gjeodezike.
  - Makineri asfaltimi, transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca,
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së punimeve në trupin e rrugës
  - Inerte, dhera të përpunuara, bitum, asfaltobeton, ujë,
  - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

#### 4. Moduli “Punime ndërtimi të veprave të artit në rrugë”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME NDËRTIMI TË VEPRAVE TË ARTIT NË RRUGË</b>	<b>M-02-886-23</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer ndërtimet e veprave të artit në rrugë.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet në ndërtimet e veprave të artit në rrugë;</li><li>- të llogaritin volumet dhe materialet për ndërtimet e veprave të artit në rrugë;</li><li>- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për ndërtimet e veprave të artit në rrugë;</li><li>- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>- të përcaktojnë radhën e kryerjes gjatë ndërtimeve të veprave të artit në rrugë;</li><li>- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>- të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja për ndërtimet e veprave të artit në rrugë.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshin uniformën e punës;</li></ul>	

- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për ndërtimet e veprave të artit në rrugë sipas manualeve të përdorimit;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të veprave të artit në rrugë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë punime për veprat e artit (urë, tombino, tunel, mure mbajtëse dhe pritëse etj.).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të theksojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punimet e veprat e artit si urat, tunelet, kryqëzimet, mbikalimet, nënkalimet, tombinot, pusetat,kanalet muret pritëse/mbajtëse,
- të hapin themelin e tombinos dhe pusetës dhe t’i japin pjerrësinë tabanit sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë shtresën mbi të cilën do të vendosen elementet e tombinos dhe pusetës, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin tubat dhe t’i lidhin ata me llaç çimento, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të hapin themelet e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusetës, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë muret e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusetës, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë shtresën veshëse të kanalit në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusetës, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë hidroizolimimin mbi tubat, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë mbushjen me dhé mbi tubat dhe ngjeshjen e dheut, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë nivelimin e shtresës sipas kushteve teknike;
- të hedhin dhe ngjeshin shtresën e zhavorrit dhe betonit, sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të ndërtimit të veprave të artit;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës

pas ndërtimit të veprave të artit;  
**Instrumentet e vlerësimit:**  
– Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe ndërtimit të veprave të artit në rrugë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe ndërtimit të veprave të artit në rrugë.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumentet dhe mjetet në ndërtimit të veprave të artit në rrugë.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe ndërtimit të veprave të artit në rrugë, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makineritë dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për kryerjen e ndërtimit të veprave të artit në rrugë.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese ,instrumentet gjeodezike.
  - Makineri transportues inertesh,uji dherash,lopata,kazma, karroca,
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së ndërtimit të veprave të artit në rrugë.
  - Inerte,dhera të përpunuara, ujë,tuba,gurë natyror
  - Pajisje kancelarie,makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 5. Moduli “Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve”

Drejtimi: Ndërtim  
Profili: Punime dhe riparim rrugësh  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>PUNIME TË RIPARIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE</b>	<b>M-02-886-23</b>
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet në punimet të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve;</li><li>- të llogaritin volumet dhe materialet për riparime dhe mirëmbajtjen e rrugëve sipas punimeve përkatëse;</li><li>- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve;</li><li>- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>- të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve;</li><li>- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>- të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshin uniformën e punës;</li></ul>	

- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë mirëmbajtjen e rrugëve**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për mirëmbajtjen e rrugëve
- të pastrojnë rrugët nga barishtet e këqija dhe mbetjet e rrezikshme me mjete dore ose të mekanizuara.
- të pastrojnë kanalet e bankinave me mjete dore ose të mekanizuara.
- të riparojnë defektet e vogla duke mbushur gropëzat me granil, sipas kushteve teknike.
- të kryejnë cilindrimin e mbushjes me grani me mjete dore ose të mekanizuara, sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë dhe riparojnë skarpatat e rrugës duke bërë përforcime me mure mbajtëse prej betoni të armuar.
- të kontrollojnë dhe riparojnë kufizuesit anësorë metalikë me aksesorët fosforeshentë;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së rrugëve;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas mirëmbajtjes së rrugëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësit kryejnë punime riparimi të gropave të krijuara në rrugë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për riparimin e gropave të krijuara në rrugë;
- të heqin shtresën e asfalt-betonit të dëmtuar me mjete dore ose të mekanizuara;
- të hapin gropën në formë kuadrati dhe ta nivelojnë fundin e saj sipas kushteve teknike;
- të pastrojnë shtresat ekzistuese të rrugës me mjete dore

- ose të mekanizuara;
- të vendosin shtresat e rrugës në vëllimin e krijuar të gropës, sipas renditjes ekzistuese dhe kushteve teknike;
  - të shtrojnë shtresën e binderit dhe ta cilindrojnë atë sipas kushteve teknike;
  - të shtrojnë shtresën e asfalt-betonit dhe ta cilindrojnë atë sipas kushteve teknike;
  - të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
  - të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
  - të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
  - të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit të rrugëve;
  - të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas riparimit të rrugëve.
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe në punimet të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe në punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore dhe në punimet të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makineritë dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për kryerjen e riparimit dhe mirëmbajtjes e rrugëve.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese ,instrumentet gjeodezike.
  - Makineri transportues inertesh,uji dherash,lopata,kazma,
-

- 
- karroca,
- Kompleti i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
  - Inerte, dhera të përpunuara, ujë, tuba, gurë natyror
  - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-



## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Punime ndërtimi trotuari”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME NDËRTIMI TROTUARI</b>	<b>M-02-1918-23</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime ndërtimi trotuari.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	51 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b></p> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë legjislacionin për ndërtime trotuari;</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, skicat dhe detajet për punime ndërtimi trotuari;</li><li>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punime ndërtimi trotuari;</li><li>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punime ndërtimi trotuari;</li><li>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve për ndërtim trotuari;</li><li>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e ndërtimit të trotuarit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	

## **RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës;
- të vendosin tabelat sinjalizuese për ndërtim trotuari;
- të kontrollojnë kuotat e shënuara të sipërfaqes për ndërtim trotuari;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të trotuarit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RN 3 Nxënësi kryen ndërtimi trotuari.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për ndërtime trotuari;
- të ngjeshin në bashkëpunim dheun e bazamentit të sipërfaqes trotuarit me rul sipas kuotave të shënuara;
- në bashkëpunim të shtrojnë dhe ngjeshin me makineri shtresën e zhavorrit sipas kuotës së dhënë;
- të fiksojnë me llaç çimentoje takot drejtuese;
- të fiksojnë me llaç çimentoje bordurat e gatshme drejtimit të spangos;
- të fiksojnë bordurat e gatshme të pemëve;
- në bashkëpunim të shtrojnë dhe ngjeshin me makineri shtresën e inerteve me trashësinë e imët;
- të mbulojnë/maskojnë gropat e pusetave dhe pemëve gjatë punimeve në trotuar;
- të realizojnë shtresën e betonit sipas kuotës përkatëse;
- të kryejnë nivelimin e sipërfaqes së shtruar me beton;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të ndërtimit të trotuareve;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve të ndërtimit të trotuareve.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të

- 
- punës, procese parapërgatitore dhe punime ndërtimi trotuari.
  - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe punime ndërtimi trotuari.
  - Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet ndërtimi trotuari.
  - Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve gjatë punimeve të ndërtimit të trotuarit.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore dhe punime ndërtimi trotuari, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica, detaje për kryerjen e ndërtimit të trotuarit në rrugë.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese ,instrumentet gjeodezike.
  - Materialet për punimet e ndërtimit trotuarit në rrugë.
  - Bordura trotuari të gatshme,inerte,llaç çimento,ujë,spango
  - Makineri transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca,
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Inerte,dhera të përpunuara, ujë, tuba, gurë natyror
  - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 2. Moduli “Punime të rrjetit inxhinierik në rrugë

Drejtimi: Ndërtim  
Profili: Punime dhe riparim rrugësh  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË RRJETIT INXHINIERIK NË RRUGË	M-02-1919-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për punimet të rrjetit inxhinierik në rrugë	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, skicat dhe detajet për punime të rrjetit inxhinierik në rrugë;</li><li>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punime të rrjetit inxhinierik në rrugë;</li><li>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punime të rrjetit inxhinierik në rrugë;</li><li>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve për punime të rrjetit inxhinierik në rrugë;</li><li>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera të punës;</li><li>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të rrjetit inxhinierik në rrugë.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshin uniformën e punës;</li></ul>	

- të vendosin tabelat sinjalizuese për punime të rrjetit inxhinjerik në rrugë;
- të kontrollojnë kuotat e shënuara të sipërfaqes për punime të rrjetit inxhinjerik në rrugë;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve të rrjetit inxhinjerik në rrugë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë punime të rrjetit inxhinjerik në rrugë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punimet e rrjetit inxhinjerik në rrugë;
- të bashkëpunojnë për përgatitjen e kanaleve dhe të vendosin tubacionet (të ujit, elektrike, telefonike);
- të hedhin shtresën e parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike;
- të bashkëpunojnë në kryerjen e cilindrit të shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike me makineri;
- të hedhin shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr të imët / çakëll sipas kushteve teknike;
- të bashkëpunojnë në kryerjen e cilindrit të shtresës së dytë (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike me makineri;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për rrjetin inxhinjerik në rrugë;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas ndërtimit të rrjetit inxhinjerik në rrugë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit, planifikimit dhe të organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe punime të rrjetit inxhinjerik në rrugë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe punimet të rrjetit inxhinjerik në rrugë.

- 
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet e rrjetit inxhinjrik në rrugë.
  - Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve gjatë punime të rrjetit inxhinjrik në rrugë.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore dhe punimet të rrjetit inxhinjrik në rrugë, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:

- Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për kryerjen e punime të rrjetit inxhinjrik në rrugë.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese ,instrumentet gjeodezike.
  - Makineri transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca,
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së punimeve të rrjetit inxhinjrik në rrugë.
  - Inerte, ujë,tuba,gurë natyror
  - Pajisje kancelarie,makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal.
-

### 3. Moduli “Punime të sinjalistikës rrugore

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË SINJALISTIKËS RRUGORE	M-02-1536-23
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet e sinjalistikës rrugore.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	51 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, skicat dhe detajet për punimet e sinjalistikës rrugore;</li><li>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e sinjalistikës rrugore;</li><li>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për punimet e sinjalistikës rrugore;</li><li>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve për sinjalistikës rrugore;</li><li>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;</li><li>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e sinjalistikës rrugore.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë punime parapërgatitore për sinjalistikën rrugore.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të veshin uniformën e punës;</li></ul>	

- të vendosin tabelat sinjalizuese dhe rrethojnë vendin do të kryhet së sinjalistika horizontale dhe vertikale, sipas kushteve teknike;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të përcaktojnë pozicionet e vendosjes së sinjalistikës horizontale dhe vertikale sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin tabelat sinjalizuese dhe rrethojnë vendin do të kryhet së sinjalistika horizontale dhe vertikale, sipas kushteve teknike;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve për sinjalistikës rrugore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë punime për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punimet për sinjalistikën rrugore;
- të shënojnë në rrugë konfiguracionin e sinjalistikës horizontale sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të bojatisin sinjalistikës horizontale me bojëra speciale sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë bazamentet për vendosjen e sinjalistikës vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin dhe montojnë elementet e sinjalistikës vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë bazamentet për vendosjen e sinjalistikës vertikale të veçuar përgjatë rrugës dhe në kryqëzime të rrugëve sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin dhe montojnë elementet e sinjalistikës vertikale të veçuar përgjatë rrugës dhe në kryqëzime të rrugëve sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për sinjalistikën rrugore;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve për sinjalistikën rrugore.

***Instrumentet e vlerësimit:***



---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore si dhe për punimet në sinjalistikën rrugore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit , planifikimit dhe organizimit të vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe punimet për sinjalistikën rrugore.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet për punimet e sinjalistikës rrugore.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve gjatë punimeve për sinjalistikën rrugore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, proceset parapërgatitore dhe punimet për sinjalistikën rrugore, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica,detaje për kryerjen e sinjalistikës rrugore.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese ,instrumentet gjeodezike.
  - Makineri transportues, uji, karroca, rul, furçë, govatë
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes së punimeve të sinjalistikës rrugore.
  - Bojëra,hollues,shirit,shabllon
  - Pajisje kancelarie,makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit të rrugëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

#### 4. Moduli “Punime gjelbërimi në rrugë”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dhe riparim rrugësh  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME GJELBËRIMI NË RRUGË	M-02-1537-23
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet e gjelbërimit në rrugë.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	51 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.</b> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, skicat dhe detajet për punimet e gjelbërimit në rrugë;</li><li>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e gjelbërimit në rrugë;</li><li>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare punimet e gjelbërimit në rrugë;</li><li>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;</li><li>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proceseve përkatëse të punës;</li><li>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve për punimet e gjelbërimit në rrugë;</li><li>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;</li><li>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;</li><li>– të koordinojnë punën me grupet e tjera të punës;</li><li>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen punimet e gjelbërimit në rrugë.</li></ul> <p><b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Nxënësit kryejnë punime parapërgatitore gjelbërimi në rrugë.</b> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshin uniformën e punës;</li><li>- të vendosin tabelat sinjalizuese për punimet e gjelbërimit</li></ul>	

- në rrugë;
- të kontrollojnë kuotat e shënuara të sipërfaqes për punimet e gjelbërimit në rrugë;
- të përcaktojnë pozicionet dhe konfiguracionin e vendosjes së gjelbërimit në rrugë sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve të gjelbërimit në rrugë.
- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punimet e gjelbërimit në rrugë.
- të shënojnë në hapësirën e caktuar pozicionin dhe konfiguracionin e gjelbërimit në rrugë sipas projektit.
- të gërmojnë gropat për vendosjen (mbjelljen) e pemëve/bimësisë për gjelbërimin horizontal në rrugë sipas projektit dhe kushteve teknike.
- të vendosin (mbjellin) pemët/bimësinë dekorative për gjelbërimin horizontal në rrugë sipas projektit.
- të ndërtojnë bazamentet për vendosjen e bimësisë dekorative vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike.
- të vendosin dhe montojnë bimësisë dekorative vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësit kryejnë punime gjelbërimi në rrugë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punimet e gjelbërimit në rrugë;
- të shënojnë në hapësirën e caktuar pozicionin dhe konfiguracionin e gjelbërimit në rrugë sipas projektit;
- të gërmojnë gropat për vendosjen (mbjelljen) e pemëve/bimësisë për gjelbërimin horizontal në rrugë sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin (mbjellin) pemët/bimësinë dekorative për gjelbërimin horizontal në rrugë sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të ndërtojnë bazamentet për vendosjen e bimësisë dekorative vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të vendosin dhe montojnë bimësisë dekorative vertikale të vazhduar përgjatë rrugës sipas projektit dhe kushteve teknike;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;

- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të gjelbërimit në rrugë;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë veglat e punës pas punimeve të gjelbërimit në rrugë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt/terren.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe të gjelbërimit në rrugë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore si dhe punimet e gjelbërimit në rrugë.
- Nxënësit duhet të përdorimin drejt veglat, instrumenteve dhe mjetet në punimet e gjelbërimit në rrugë.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, instrumenteve gjatë punimeve të gjelbërimit në rrugë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të analizimit, planifikimit dhe organizimit të vogël të punës, procese parapërgatitore dhe punime të gjelbërimit në rrugë, si dhe të llogaritjeve të volumeve e materialeve për këto punime.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:
- Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
  - Pankarta me skica, detaje për kryerjen e punimeve të gjelbërimit në rrugë.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese, instrumentet gjeodezike.
  - Makineri transportues pemë dekorative, uji, dherash, lopata, kazma, karroca,
  - Komplet i veshjes së punës.
  - Materialet për punimet e kryerjes e punimeve të gjelbërimit në rrugë.
  - dhera të përpunuara me pleh, ujë, tuba, pemë dekorative
  - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse.
  - profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
-